



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KORÇË

VENDIM

Nr. 13, dt. 22.12.2021

MBI MIRATIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE, KLASIFIKIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË FUNKSIONARËVE TË ZGJEDHUR E TË EMËRUAR DHE TË PUNONJËSVE TË ADMINISTRATËS TË KËSHILLIT TË QARKUT PËR VITIN 2022

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit “Për Buxhetin e Vitit 2022”, Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, Ligjit nr 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 177 dt. 08.03.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 165 date 02.03.2016 të Këshillit të Ministrave “Për grupimin e njësive të qeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar, të nëpunësve civile e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, si dhe vendimit të Këshillit të Qarkut nr. 7 date 26.04.2017 “Mbi miratimin e nivelit të ri të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civile e të punonjësve të administratës të Këshillit të Qarkut”, me propozim të Kryesisë, Këshilli i Qarkut

VENDOSI

1. Të miratoje Strukturën organizative dhe klasifikimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar dhe të punonjësve të administratës të Këshillit të Qarkut për vitin 2022 sipas tabelës bashkangjitur.
2. Efektet financiare do të perballohen brenda fondit të pagave të miratuar për vitin 2022.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e finances, zhvillimit ekonomik, shërbimeve, burimeve njerezore dhe zhvillimit të territorit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga dt. 01.01.2022.

Kryetari i Këshillit të Qarkut

Ana VERUSHI

Konceptoi L.Pleqi
Juristi Gj. Kristo
Sek.K.Qarkut B. Muço





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT KORÇË

RELACION

***MBI MIRATIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE, KLASIFIKIMIN E NIVELIT
TË PAGAVE TË FUNKSIONARËVE TË ZGJEDHUR E TË EMËRUAR DHE TË
PUNONJËSVE TË ADMINISTRATËS,
TE KËSHILLIT TË QARKUT PËR VITIN 2022***

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit “Për Buxhetin e Vitit 2022”, Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” I ndryshuar, Ligjit nr 7961 datë 12.07.1995 “Kodi I Punës në Republikën e Shqipërisë” I ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 177 dt. 08.03.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 165 date 02.03.2016 të Këshillit të Ministrave “Për grupimin e njësive të qeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar, të nëpunësve civile e të punonjësve administrative të njësive të vetëqeverisjes vendore”, si dhe vendimit të Këshillit të Qarkut nr. 7 date 26.04.2017 “Mbi miratimin e nivelit të ri të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civile e të punonjësve të administratës të Këshillit të Qarkut”, I propozojmë Këshillit të Qarkut miratimin e disa ndryshimeve në strukturën organizative të Administratës së Këshillit të Qarkut si dhe rikonfirmimin e nivelit të pagave për vitin 2022.

Për ritjen e cilësise së punës në funksion të permbushjes së detyrave funksionale të Këshillit të Qarkut dhe përmirësimin e punës në drejtim të marrëdhënieve me komunitetin dhe ofrimin e shërbimeve në një afat kohor sa më të shpejtë, propozojmë që pozicioni I punës të ndryshojë emërtimi “Zedhenes i Zyres së Kryetarit dhe shërbime të tjera” dhe të emerotohet “Punonjes i informacionit dhe shërbime të tjera”, sipas tabelës bashkëngjitur. Ndryshimet do të jenë Brenda numurit 10 të punonjësve të miratuar me Ligjin e Buxhetit. Ndryshimet në strukture do të rritin nivelin e punës në Administratën e Këshillit të Qarkut, duke bërë të mundur mbulimin e një sfere më të gjere të shërbimeve.

Niveli i pagave do të jetë ai i vitit aktual sipas pozicioneve të miratuara, në zbatim të VKM nr. 177 dt. 08.03.2017 dhe në funksion të ngarkesës së punës.

Mbi bazën e ketyre niveleve janë llogaritur edhe fondet e pagave dhe sigurimeve shoqërore, të cilat janë parashikuar në buxhetin e Këshillit të Qarkut për vitin 2022.

Sa më sipër paraqitim për miratim strukturën organizative dhe klasifikimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar si dhe të punonjësve të administratës së Këshillit të Qarkut për vitin 2022 sipas tabelës bashkëngjitur.

Korce më 10.12.2021

Liljana PLEQI
Drejtoreshë Finances

**STRUKTURA ORGANIZATIVE E ADMINISTRATES TE
KESHILLIT TE QARKUT PER VITIN 2022**

V.K.M.177 dt 08.03.2017 Për disa shtesa e ndryshime ne vendimin 165 dt. 02.03.2016 te Keshillit te Ministrave "Për grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave te funksionareve te zgjedhur e te emeruar, te nepunesve civile e të punonjësve administrative të njësive të qeverisjes vendore"

Nr.	Njësia strukturore	Nr puno-njësve	Niveli Lidhja 7	Paqa Gr, sipas Kat.diplom	Paqa e grupit	Vjetërsi 2%	Paqa e pozicionit	Statusi I punonjesit
I	Kryetar i Këshillit të Qarkut	1	I/e				150000	Të zgjedhur
II	Zyendëskryetar i Këshillit të Qarkut	1	I/e				101650	Të zgjedhur
III	Sekretar i Këshillit të Qarkut	1	I-b	1	14000	2%	80000	Të emeruar K.Qarkut
IV	Kabineti i Kryetarit							
	Drejtor i kabinetit te kryetarit - Keshilltar juridik	1	I-b	1	14000	2%	91600	Pozicion pune me kontratë
	Keshilltar i maredhenieve me publikun dhe mediat	1	II-b	1,2	14000/11000	2%	73000	Pozicion pune me kontratë
	Keshilltar per Projektet e Bashkimit European	1	II-b	1,2	14000/11000	2%	79600	Pozicion pune me kontratë
	Punonjes I informacionit dhe sherbime te tjera	1	III-b	1,2	14000/11000	2%	51000	Pozicion pune me kontratë
V	Drejtoria e finances, zhvillimit ekonomik, sherbimeve, burimeve njerezore dhe zhvillimit te territorit							
	Drejtor I Finances dhe Buxhetit	1	II-b	1	14000	2%	79600	Pozicion pune shërbimi civil
	Specialist i nivelit të lartë për Shërbimet, Burimet Njerezore dhe Emergjencat Civile	1	III-b	1,2	14000/11000	2%	61000	Pozicion pune shërbimi civil
	Sektori I Urbanistikes, zhvillimit te territorit dhe programeve te zhvillimit te Rajonit							
	Specialist i nivelit të lartë për Urbanistikën dhe Zhvillimin e Teritorit	1	III-b	1,2	14000/11000	2%	61000	Pozicion pune shërbimi civil
	Specialist I nivelit te larte per programet e zhvillimit	1	III-b	1,2	14000/11000	2%	61000	Pozicion pune shërbimi civil
	Specialist per Shendetsine dhe Ceshjet sociale, arsimin dhe Kulturen	1	III-b	1,2	14000-11000	2%	61000	Pozicion pune shërbimi civil
	Sektori I sherbimeve mbeshtetese							
	Shofer autoveture I institucionit	1	P.19/20			1%	39000	Pozicion pune me kontratë
	Totali Administrata	13						

Kryetar i Këshillit të Qarkut

Ana VERUSHI

